



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 240/1 prot.

Tiranë më 08.02.2023

Lënda: Mendim mbi projektligjin *“Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin Penitenciar”*.

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr. 466 prot., datë 24.01.2023, me anë të së cilës dërgohet për mendim projektligji *“Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin Penitenciar”* (në vijim *“projektligji”*) si dhe dokumentet shoqëruese.

Nga shqyrtimi i projektaktit, Zyra e Komisionerit vlerëson se në tërësi, ky projektligj zbaton standardet e mbrojtjes së të dhënave personale. Megjithatë, do të vlerësonim marrjen në konsideratë nga ana juaj të sugjerimeve në vijim.

Në lidhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 22, të këtij projektligji, Zyra e Komisionerit vlerëson se, përmbajtja e tyre nuk është në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar (në vijim *“Ligji”*), për shkak se e lë të hapur mundësinë e ndërveprimit për shkëmbimin e të dhënave personale (me marrëveshjeve apo memorandume bashkëpunimi), pra në diskrecion të vetë Agjencisë, ndërkohë që marrja e të dhënave nga subjekte të tjera, duhet të autorizohet nga një dispozitë ligjore, si dhe duhet të lidhet vetëm me fushën e veprimtarisë së këtij ligji.

Sa më sipër, marrë në konsideratë parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se këto dy pika duhen riformuluar, me qëllim që të qartësohen subjektet shtetërore apo private të cilat do ti vendosin në dispozicion të dhëna Agjencisë. Gjithashtu, këto parashikime duhet të vijnë në përputhje me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit, konkretisht parimet dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale, në lidhje me përcaktimin e niveleve të aksesit, kategoritë e informacionit që do të shkëmbehet, etj., të cilat duhet të lidhen vetëm me qëllimin e përpunimit.

Në lidhje me nenit 25, të projektligjit në të cilin parashikohet *“Përfshirja nga publikimi”*, vlerësojmë se është i paqartë qëllimi dhe kategoritë e informacionit/dokumentacionit që përjashtohen nga detyrimi për publikim. Nga mënyra e formulimit, kjo dispozitë nuk vjen në të njëjtën linjë me kufizimet e parashikuara në nenin 17, të ligjit nr.119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*. Në këtë kuadër, sugjerojmë që neni 25 i projektligjit, të riformulohet në funksion të qartësisë së tij, duke patur në konsideratë legjislacionin për të drejtën e informimit dhe veçanërisht parashikimet e nenit 17, ku rregullohen të gjitha rastet në të cilat kufizohet e drejta për informim.

Pas pikës *“dh”*, të nenit 49, sugjerojmë të shtohet një pikë *“e”* me këtë përmbajtje: *“Punonjësi operacional, gjatë ushtrimit të detyrës, mbart detyrimin për ruajtjen e sekretit profesional për të dhënat personale, tek të cilat ka pasur akses për arsye profesionale, dhe ua zbulon ato të tretëve vetëm sipas ligjit.”*

Zyra e Komisionerit sugjeron gjithashtu, se në nenin 56, të shtohet një pikë e katërt me këtë përmbajtje: *“4. Të dhënat e grumbulluara nga Agjencia, duhet të lidhen vetëm me qëllimin e përpunimit të përcaktuar në misionin e Agjencisë, si dhe përpunimi i tyre duhet bërë duke zbatuar masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm, me qëllim për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave.”*

Së fundmi, sugjerojmë që në pikën 2, të nenit 56, të projektligjit, pas togfjalëshit: *“... për mbrojtjen e të dhënave”*, të shtohet fjala *“personale”*.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi